



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 696/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Anulimin e procedurës së prokurimit me Nr.REF-21330-05-09-2019, me objekt: *“Blerje goma për automjete”*, Loti I, me fond limit 50.279.555 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “Gajd Company” sh.p.k
Rruga e Kavajës, Pallati nr.29, Kulla B, Ap.36,Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

Subjekte te Interesuar: “Ra-Mi Kompani” sh.p.k
Njesia Bashkiake nr.3, Rruga "Tele Ndini", Pallati nr.1, kati 1, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-21330-05-09-2019, me objekt: “*Blerje goma për automjete*”, Loti I, me fond limit 50.279.555 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 27.06.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1.	“R&R Group” sh.p.k	1.237.376 lekë, kualifikuar
2.	“C.A.A” sh.p.k	1.255.000 lekë, skualifikuar
3.	“Alked Kopaci” p.f	1.484.056 lekë, skualifikuar
4.	“Ra-Mi Kompani” sh.p.k	1.979.800 lekë, kualifikuar
5.	“Klosi-R Compant” sh.p.k	2.227.277 lekë, skualifikuar
6.	“Gajd Company” sh.p.k.	2.473.000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 04.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e operatorëve ekonomikë “R&R Group” sh.p.k dhe “Ra-Mi Company” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]”

Në datën 27.06.2019 bëhemi me dije nëpërmjet SPE të APP-së në lidhje me renditjen e kualifikimit të procedurës ku në vend të parë renditet “R&R Group” sh.p.k, me ofertë 1.237.376 shumatore të cmimeve për njësi dhe “Ra-Mi Company” sh.p.k me ofertë 1.979.800 lekë shumatore e cmimeve për njësi, ku ofertat janë dukshëm anomalisht të ulta.

Nga eksperiencia jonë në këtë sektor me rreth mbi 15 vjet, ofrimi i këtyre mallrave me specififikimet teknike të kerkuara dhe kërkesat teknike në DT, është në mënyrë absolute e pamundur. Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët është komplet i pamundur dhe nëse është kërkuar një i tillë, fare lehtë që është një deklaram i rremë ose një manipulim i të dhënave të cmimeve, me qëllim që të krijojë idenë se operatorët e lartpërmendur mund të ofrojnë këto mallra. Kjo gjë, me këto oferta, është e pamundur pasi sipas specifikimeve teknike të kerkuara në DT, prodhuesi më i lirë do të dilte në treg me ofertë më të lartë se vetë operatorët në fjalë.

Gjithashtu vëmë në dyshim të thellë fiksimin e ofertave në tender, pasi këto dy firma të cilat janë krijuar nga një person i vetëm dhe më pas me lëvizje të shitblerjeve të ndryshme të aksioneve, japin idenë sikur në të vërtetë ekzistojnë dy firma të ndryshme por në drejtimin e të dyjave është i njëjti person i vetëm, gjë që ka bërë edhe fiksimin e cmimit në tender, duke thyer ligjin për prokurimin publik si dhe ligjin për konkurrencën, të mbikqyrur nga Autoriteti i Konkurrencës.

Gjithashtu operatorët në fjalë nuk plotësojnë pikën 5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku thuhet se: “operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, pasi operatorët ekonomikë nuk kanë eksperiencën e duhur për të pasur marrëveshje me një numër të konsiderueshëm prodhuesish apo distributorësh të autorizuar nga prodhuesit për të paraqitur gamën e madhe të llojshmërisë së gomave që janë në procedurë. Është lehtësisht e vërtetueshme që operatorët ekonomikë kanë copëtuat kataloge të prodhuesve të ndryshëm, duke i bashkuar në disa prej tyre me qëllim të ulin numrin e autorizimeve nga prodhuesit dhe duke e bërë në mënyrë fiktive sikur një distributor apo një prodhues të ketë më shumë lloje gomash nga sa prodhon (me pak fjalë kanë bërë një franchize të paligjshëm dhe pa kurrfarë kontrate, një manipulim i hapur në këtë rast me qëllim kualifikimin në tender dhe daljen fitues në të, duke gënjyer me cmimet e tyre). Kjo vërtetohet fare lehtë ku mjafton ti nisni një e-mail prodhuesve apo distributorëve që kanë paraqitur operatorët në fjalë dhe do të merrni një përgjigje negative për një numër të konsiderueshëm tipe gomash të cilat nuk i disponojnë (pasi katalogët janë të firmave të tjera).

Verifikimi i manipulimit të katalogëve mund të bëhet akoma më thjesht. Ka disa lapsuse të bëra nga ABP gjatë hedhjes së procedurës, ku goma me nr. rendor nr.10 është hedhur gabim. Konkretisht: Goma 11.00 R 20 TT 150/146 H. Ky artikull është gomë kamioni ku specififikimet teknike të vendosura për këtë artikull nga ABP-ja tregojnë që kamioni në të cilin do të përdoren

këto goma, kanë një shpejtësi mbi 200 km/h. Një kamion me shpejtësi mbi 200 km/h nuk ekziston në asnjë autoritet kontraktor në Shqipëri. Në fakt një kamion i tillë nuk ekziston në asnjë vend të botës. Si rrjedhojë një gomë e tillë, pra gomë kamioni që përballon shpejtësi mbi 200 km/h nuk ekziston. Me pak fjalë ky është një lapsus i bërë nga personat që kanë bërë specifikimet teknike. Ndërkohë kemi bindje të plotë se personi që ka krijuar këto dy kompani të renditura e para dhe e dyta në këtë procedurë (dhe si rrjedhojë këto dy operatorë ekonomikë) kanë paraqitur në këtë procedurë specifikime teknike dhe kataloge për artikullin nr.10 goma 11.00 R 20 TT 150/146 H njëlloj si është kërkuar në DT nga ABP-ja. Dy operatorët ekonomikë të renditur i pari dhe i dyti, kanë paraqitur katalogë ku figuron goma “11.00 R 20 TT 150/146 H” e cila nuk ekziston. Katalogët origjinale nuk mund të kenë një artikull (gomë) e cila nuk ekziston dhe jo të prodhohet. Kjo na lë të kemi bindjen e plotë dhe të faktuar tashmë me fakte konkrete se të dy operatorët ekonomikë të lartpërmendur dhe pjesë e objektit të ankesës së paraqitur nga ne të renditur i pari dhe i dyti, të kenë falsifikuar këto dokumenta tenderi. Sigurisht falsifikimi i dokumentave me qëllim kualifikimin në tendera është një vepër e cila, sipas ligjit për prokurimin publik, përbën kusht për skualifikimin e tyre të menjëhershëm. Gjithashtu, sipas ligjit të prokurimit publik, autoriteti kontraktor duhet të vërë në dijeni APP-në në lidhje me këtë falsifikim të këtyre operatorëve ekonomikë. Përsa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorëve ekonomikë “R&R Group” sh.p.k dhe dhe “Ra-Mi Company” sh.p.k dhe rirenditjen edhe njëherë të operatorëve në këtë procedurë.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1237/2 prot., datë 11.07.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

[...]

I. Ofertuesi “Gajd Company” sh.p.k ka ankimuar kualifikimin e ofertuesve pjesëmarrës “R&R Group” sh.p.k dhe “Ra-Mi Kompani” sh.p.k me pretendimin si vijon: “Në datën 27.06.2019 bëhemi me dije nëpërmjet SPE të APP-së në lidhje me renditjen e kualifikimit të procedurës ku në vend të parë renditet “R&R Group” sh.p.k, me ofertë 1.237.376 shumatore të cmimeve për njësi dhe “Ra-Mi Company” sh.p.k me ofertë 1.979.800 lekë shumatore e cmimeve për njësi, ku ofertat janë dukshëm anomalisht të ulta. Nga eksperiencia jonë në këtë sektor me rreth mbi 15 vjet, ofrimi i këtyre mallrave me specifikimet teknike të kërkuara dhe kërkesat teknike në DT, është në mënyrë absolute e pamundur. Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët është komplet i pamundur dhe nëse është kërkuar një i tillë, fare lehtë që është një deklaram i rremë ose një manipulim i të dhënave të cmimeve me qëllim që të krijojë idenë se operatorët e lartpërmendur mund të ofrojnë këto mallra. Kjo gjë, me këto oferta, është e pamundur pasi, sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DT, prodhuesi më i lirë do të dilte në treg me ofertë më të lartë se vetë operatorët në fjalë.”

I/1 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k për këtë procedurë prokurimi, konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga gjenerimi i renditjes përfundimtare në SPE ka konstatuar se, oferta ekonomike e dorëzuar nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k me vlerë 1.237.376 lekë pa tvsh shumatore të cmimeve për njësi, rezulton anomalisht e ulët.

Për këtë arsye bazuar në nenin 56 të LPP-së, KVO-ja ka kërkuar nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k sqarime lidhur me ofertën anomalisht të ulët, me shkresën nr. prot. 1151, datë 24.06.2019 me lënd: “Kërkesë për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët”.

Në shkresë i kërkohet ofertuesit “R&R Group” sh.p.k të paraqesë me shkrim ose në rrugë elektronike, brenda 3 (tre) ditëve pune, shpjegime për elementë të vecantë të ofertës më konkretisht:

- anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Ofertuesi “R&R Group” sh.p.k ka respektuar afatin kohor të përcaktuar, duke kthyer përgjigje me shkresën nr.prot., 1151/1, datë 26.04.2019 me lëndë: “Argumentimi dhe analiza e kostos për cmimet e paraqitura në ofertën me datë 10.06.2019 për procedurën e llojit të hapur me objekt: blerje goma për automjete, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara” ku ka shpjeguar elementët e vecantë të ofertës anomalisht të ulët.

Për anën ekonomike të procesit të prodhimit, ofertuesi ka paraqitur argumentat për kapacitetin e tij njerëzor, teknik dhe financiar, analizë kosto të artikujve dhe ecurinë pozitive të bilanceve financiare në vite;

Për zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht tjetër favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e mallrave, ofertuesi është shprehur mbi gjëndjen e magazinës, për automjetet dhe kapacitetet të ndryshme të shoqërisë;

Për origjinalitetin e mallrave, ofertuesi ka paraqitur fatura tatimore blerje nga kompani që operojnë prej shumë vitesh në fushën e prodhimit të gomave, nga prodhues të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit;

Për zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, ku do të sigurohet furnizimi, ofertuesi në sajë të eksperiencës disavjecare në këtë fushë, ka argumentuar se zotëron kapacitete njerëzore, teknike dhe financiare për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që mund të dalin gjatë zbatimit të kontratës.

Ofertuesi në shkresën e kthim përgjigje, për sqarime dhe argumentime të ofertës anomalisht të ulët, ka bashkëngjitur dokumentacion provues si: tabelë analizë për koston e artikujve; deklarata doganore; fatura furnizimi dhe gjendje inventari të magazinës me kostot përkatëse.

Duke qënë se oferta ekonomike e paraqitur nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k ka argumenta për të gjithë elementët e vecantë të anës ekonomike të mallrave të ofertuara, zgjidhjet teknike, origjinalitetit të mallrave dhe zbatueshmërisë së detyrimeve, në përputhje me ligjin, - krijohet

bindja se oferta e paraqitur është konform parashikimeve ligjore me të gjitha elementët e saj dhe pranohet si e rregullt.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Gajd Company” sh.p.k nuk pranohet.

1.2 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e hapjes dhe shqyrtim të ofertave mbajtur nga KVO-ja, dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ofertuesi “Ra-Mi Kompani” sh.p.k për këtë procedurë prokurimi, konstatoi se:

Nga gjenerimi i renditjes përfundimtare në SPE rezulton se oferta ekonomike e paraqitur nga ofertuesi “Ra-Mi Kompani” sh.p.k nuk është anomalisht e ulët. Pas përlllogaritjes së ofertës anomalisht të ulët sipas formulës të parashikuar në rregullat e prokurimit publik rezultoi se oferta e “Ra-Mi Kompani” sh.p.k është më e madhe se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme pjesëmarrëse.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Gajd Company” sh.p.k nuk pranohet.

II. Oferuesi “Gajd Company” sh.p.k ka ankimuar kualifikimin e ofertuesve pjesëmarrës “R&R Group” sh.p.k dhe “Ra-Mi Kompani” sh.p.k me pretendimin si vijon: “vëmë në dyshim të thellë fiksimin e ofertave në tender, pasi këto dy firma të cilat janë krijuar nga një person i vetëm dhe më pas me lëvizje të shitblerjeve të ndryshme të aksioneve, japin idenë sikur në të vërtetë ekzistojnë dy firma të ndryshme por në drejtimin e të djave është i njëjti person i vetëm, gjë që ka bërë edhe fiksimin e cmimit në tender, duke thyer ligjin për prokurimin publik si dhe ligjin për konkurrencën, të mbikqyrur nga Autoriteti i Konkurrencës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ofertuesi “Ra-Mi Kompani” sh.p.k dhe “R&R Group” sh.p.k dhe kërkimit në faqen zyrtare të QKB-së, sqarojmë se:

Të dhënat në ekstraktet e thjeshta të Regjistrimit Tregtar të sh.p.k-ve “Ra-Mi Kompani” dhe “R&R Group” përsonat fizike me detyrë administrator dhe ortak rezulton se nuk janë të njëjtë.

Për më tepër theksojmë se të dy ofertuesit “Ra-Mi Kompani” dhe “R&R Group” pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, kanë plotësuar dhe paraqitur në SPE Shtojcën nr.2/1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur” ku vetdeklarojnë që kanë përgatitur ofertën e tyre në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me asnjë konkurrent tjetër.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Gajd Company” sh.p.k nuk pranohet.

III. Ofertuesi “Gajd Company” sh.p.k ka ankimuar kualifikimin e ofertuesve pjesëmarrës “R&R Group” sh.p.k dhe “Ra-Mi Kompani” sh.p.k për mospërmbushjen e pikës 6 në seksionin 2.3 “Kapaciteti teknik” në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në DT: “Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, me pretendimin si vijon: “Pasi operatorët ekonomikë nuk kanë eksperiencën e duhur për të pasur marrëveshje me një numër të konsiderueshëm prodhuesish apo distributorësh të autorizuar nga prodhuesit për të paraqitur gamën e madhe të llojshmërisë së gomave që janë në procedurë, është lehtësisht e vërtetueshme që operatorët ekonomikë kanë copëtuar kataloge të

prodhuesve të ndryshëm, duke i bashkuar në disa prej tyre me qëllim të ulin numrin e autroizimeve nga prodhuesit dhe duke e bërë në mënyrë fiktive sikur një distributor apo një prodhues të ketë më shumë lloje gomash nga sa prodhon (me pak fjalë kanë bërë një franchize të paligjshëm dhe pa kurfarë kontrate, një manipulim i hapur në këtë rast me qëllim kualifikimin në tender dhe daljen fitues në të, duke gënjyer me cmimet e tyre). Kjo vërtetohet fare lehtë ku mjafton ti nisni një e-mail prodhuesve apo distributorëve që kanë paraqitur operatorët në fjalë dhe do të merrni një përgjigje negative për një numër të konsiderueshëm tipe gomash të cilat nuk i disponojnë (pasi katalogët janë të firmave të tjera). Verifikimi i manipulimit të katalogëve mund të bëhet akoma më thjesht. Ka disa lapsuse të bëra nga ABP gjatë hedhjes së procedurës, ku goma me nr. rendor nr.10 është hedhur gabim. Konkretisht: Goma 11.00 R 20 TT 150/146 H. Ky artikull është gomë kamioni ku specifikimet teknike të vendosura për këtë artikull nga ABP-ja tregojnë që kamioni në të cilin do të përdoren këto goma, kanë një shpejtësi mbi 200 km/h. Një kamion me shpejtësi mbi 200 km/h nuk ekziston në asnjë autoritet kontraktor në Shqipëri. Në fakt një kamion i tillë nuk ekziston në asnjë vend të botës. Si rrjedhojë një gomë e tillë, pra gomë kamioni që përballon shpejtësi mbi 200 km/h nuk ekziston. Me pak fjalë ky është një lapsus i bërë nga personat që kanë bërë specifikimet teknike. Ndërkohë kemi bindje të plotë se personi që ka krijuar këto dy kompani të renditura e para dhe e dyta në këtë procedurë (dhe si rrjedhojë këto dy operatorë ekonomikë) kanë paraqitur në këtë procedurë specifikime teknike dhe kataloge për artikullin nr.10 goma 11.00 R 20 TT 150/146 H njëlloj si është kërkuar në DT nga ABP-ja. Dy operatorët ekonomikë të renditur i pari dhe i dyti, kanë paraqitur katalogë ku figuron goma “11.00 R 20 TT 150/146 H” e cila nuk ekziston. Katalogët origjinale nuk mund të kenë një artikull (gomë) e cila nuk ekziston dhe jo të prodhohet. Kjo na lë të kemi bindjen e plotë dhe të faktuar tashmë me fakte konkrete se të dy operatorët ekonomikë të lartpërmendur dhe pjesë e objektit të ankesës së paraqitur nga ne të renditur i pari dhe i dyti, të kenë falsifikuar këto dokumenta tenderi. Sigurisht falsifikimi i dokumentave me qëllim kualifikimin në tendera është një vepër e cila sipas ligjit për prokurimin publik përbën kusht për skualifikimin e tyre të menjëhershëm. Gjithashtu po sipas ligjit të prokurimit publik, autoriteti kontraktor duhet të vërë në dijeni APP-në në lidhje me këtë falsifikim të këtyre operatorëve ekonomikë. Përsa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorëve ekonomikë “R&R Group” sh.p.k dhe dhe “Ra-Mi Company” sh.p.k dhe rirenditjen edhe njëherë të operatorëve në këtë procedurë.”

III/1 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave mbajtur nga KVO-ja, dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ofertuesi “Ra-Mi Kompani” sh.p.k dhe “R&R Group” sh.p.k për këtë procedurë prokurimi, konstatoi se:

Ofertuesi “R&R Group” sh.p.k ka paraqitur në SPE ofertën teknike sipas “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 7 (sipas tabelës) ku një ndër të dhënat e kërkuara për efekt verifikimi është edhe emri i kompanisë prodhuese të produkteve të ofruara. Për secilën nga këto kompani prodhuese ofertuesi ka paraqitur autorizim prodhuesi në gjuhë të huaj, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin, të pajisur me vërtetim noterial.

Në autorizimet e lëshuara nga kompanitë prodhuese, është shprehur edhe për brand-et, për të cilat këta prodhues japin të drejtën e tregtimit ofertuesit “R&R Group”. Katalogët e brand-ve të cilat ofertuesi ka paraqitur në SPE, përkojnë me brand-et e cituar në autorizimin e sjellë në gjuhë

të huaj, të përkthyer në gjuhën shqipe. Katalogët janë të paraqitur në gjuhë të huaj (origjinal) të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin me vërtetim noterial.

Referuar dokumentacionit të ofertuesit për aktet noteriale të katalogëve dhe të autorizimeve të cilët rezultojnë të jenë origjinal, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar nga vullneti i noterit publik për vërtetimin e dokumentit me njësimin e origjinalit ku evidentohet se: akti i përkthyer nuk përmban fshirje, korrigjime, modifikime dhe përgjithësisht ndërhyrje në aktin origjinal - Organi Qëndror Blerës nuk ka patur dyshime për korrigjime, mbivendosje, të cilat mund të linin vend për dyshime të fallsifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Gajd Company” sh.p.k nuk pranohet.

III.2 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave mbajtur nga KVO, dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k dhe “Gajd Company” sh.p.k, specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi, ofertën ekonomike datë 12.12.2018 me nr. Prot., 1282 nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k për testim tregu për objektin “Blerje goma për automjete:”, konstatoi se:

Për objektin e prokurimit “Blerje pjesë këmbimi për automjete për shërbime profilaktike” e konkretisht për lotin 1 “Blerje goma për automjete” specifikimet teknike janë unifikuara nga Organi Qëndror Blerës, në konsultim me operatorët ekonomikë që operojnë në qarkullimin civil-në tregun shqiptar, për artikujt të përcaktuar në specifikimet teknike.

Gjatë hartimit të specifikimeve teknike, me qëllim unifikimin e tyre, përkatësisht për artikullin që përkon me nr.39 të tabelës përfundimtare me emërtim “11.00 R 20 TT 150/146 H” nuk ka patur sugjerime apo kundërshtime nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Operatori juaj ekonomik i është përgjigjur ftesës së Organit Qëndror Blerës për kryerjen e testimit të tregut për objektin “Blerje goma për automjete” me ofertën e depozituar pranë institucionit tonë datë 12.12.2018 me nr. 1282 prot.

Në përmbajtje të ofertës ekonomike (testim tregu), rezulton të jetë ofruar nga ana juaj artikulli nr. 39 me emërtim “11.00 R 20 TT 150/146 H” me vlerë të reflektuar 52.000 lekë pa tvsh (cmim për njësi).

Sa më sipër, në rast se do të kishit pretendime mbi mosekzistencën në katalog edhe në treg të artikullit me emërtim “11.00 R 20 TT 150/146 H”, ju me siguri nuk do të kishit shprehur vullnetin tuaj të reflektuar me vlerë/cmim për njësi, gjatë testimit të tregut për objektin “Blerje goma për automjete”.

Theksojmë se oferta juaj e sjellë hard-copy, edhe në formë elektronike, nuk përmban sugjerime konkretisht për artikullin nr. 39 me emërtimin “11.00 R 20 TT 150/146 H”, të vendosur në specifikimet teknike, gjatë kryerjes së testimit të tregut.

Për më tepër ofertuesi nëse do të kishte paqartësi për dokumentat e tenderit, në fazën e publikimit të tyre mund të kishte kërkuar shpjegim bazuar në nenin 42 të LPP-së. Nëse do të kishte kundërshtim për kriteret kualifikuese ose kërkesat e specifikimeve teknike duhet të kishte paraqitur ankesë brenda 7 ditëve nga publikimi i procedurës bazuar në nenin 63 të LPP-së. Në fazën e vlerësimit të ofertave ky pretendim quhet i rënë në dekadencë pasi me të drejtë KVO shqyrton

dhe vlerëson dokumentacionin teknik të paraqitur respektivisht në SPE në përputhje të plotë me kriteret kualifikuese të hartuara në dokumentat e tenderit.

Ofertuesi “R&R Group” sh.p.k ka paraqitur në SPE ofertën ekonomike dhe ofertën teknike, ku artikulli nr. 10 (sipas specifikimeve teknike) me emërtimin “11.00 R 20”, indeksi i shpejtësisë është (H). Në katalogun origjinal, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin me vërtetim noterial, artikulli nr.10 me emërtim “11.00 R 20” rezulton me të njëjtin “indeks shpejtësie” (H), sic është e përcaktuar në specifikimet teknike në DT. Ofertuesi “R&R Group” sh.p.k në përmbajtje të katalogut origjinal, disponon për artikullin e sipërcituar edhe indeks shpejtësie “M” edhe indeks shpejtësie “K”.

Ofertuesi “Gajd Company” sh.p.k ka paraqitur ofertën ekonomike edhe ofertën teknike për artikullin nr.10, me emërtim “11.00 R 20 TT 150/146 H” ,sipas kërkesave të specifikimeve teknike në DT, ndërkohë në katalogun e paraqitur rezulton se, artikulli është përcaktuar me indeks shpejtësie të ndryshëm nga ai i hartuar në ofertën ekonomike dhe ofertën teknike të ofertuesit. Pra ku evidentialisht konstatohet se indeksi i shpejtësisë nuk përkon me ofertën ekonomike edhe atë teknike, por as me indeksin e shpejtësisë të përcaktuar në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Sa më lart, ju sjellim në vëmendje se operatori juaj ekonomik, si ofertues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjete” është kualifikuar si ofertë e vlefshme me devijime të vogla nga Organi Qëndror Blerës.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Gajd Company” sh.p.k nuk pranohet.

III.3 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave, mbajtur nga KVO-ja, dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ofertuesi “R&R Group” sh.p.k dhe “Ra-Mi Kompani” sh.p.k për këtë procedurë prokurimi, konstatoi se:

Ofertuesi “R&R Group” sh.p.k përmbush kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DT, dhe nga arsyetimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbetet i kualifikuar. Nisur nga ky fakt pretendimet e ofertuesit “Gajdi Company” sh.p.k ndaj vendimit të KVO-s për kualifikimin e ofertës së ofertuesit “Ra-Mi Kompani” sh.p.k nuk legjitimohen të merren në shqyrtim pasi nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes. Në mbështetje të legjisllacionit në fuqi për prokurimin publik , interesi i ligjshëm i drejtperdrejtë i ankimuesit nuk ka se si të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare,para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Gajd Company” sh.p.k nuk pranohet.”

II.5. Në datën 19.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si vijon:

Vëmë në dyshim të thellë fiksimin e ofertave në tender, pasi këto dy firma të cilat janë krijuar nga një person i vetëm dhe më pas me lëvizje të shitblerjeve të ndryshme të aksioneve, japin idenë sikur në të vërtetë ekzistojnë dy firma të ndryshme por në drejtimin e të dyjave është i njëjti person i vetëm, gjë që ka bërë edhe fiksimin e cmimit në tender, duke thyer ligjin për prokurimin publik si dhe ligjin për konkurrencën, të mbikqyrur nga Autoriteti i Konkurrencës.

Gjithashtu operatorët në fjalë nuk plotësojnë pikën 5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku thuhet se: “operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, pasi operatorët ekonomikë nuk kanë eksperiencën e duhur për të pasur marrëveshje me një numër të konsiderueshëm prodhuesish apo distributorësh të autorizuar nga prodhuesit për të paraqitur gamën e madhe të llojshmërisë së gomave që janë në procedurë. Është lehtësisht e vërtetueshme që operatorët ekonomikë kanë copëtuar kataloge të prodhuesve të ndryshëm, duke i bashkuar në disa prej tyre me qëllim të ulin numrin e autorizimeve nga prodhuesit dhe duke e bërë në mënyrë fiktive sikur një distributor apo një prodhues të ketë më shumë lloje gomash nga sa prodhon (me pak fjalë kanë bërë një franchise të paligjshëm dhe pa kurrfarë kontrate, një manipulim i hapur në këtë rast me qëllim kualifikimin në tender dhe daljen fitues në të, duke gënjyer me cmimet e tyre). Kjo vërtetohet fare lehtë ku mjafton ti nisni një e-mail prodhuesve apo distributorëve që kanë paraqitur operatorët në fjalë dhe do të merrni një përgjigje negative për një numër të konsiderueshëm tipe gomash të cilat nuk i disponojnë (pasi katalogët janë të firmave të tjera). Verifikimi i manipulimit të katalogëve mund të bëhet akoma më thjesht. Ka disa lapsuse të bëra nga ABP gjatë hedhjes së procedurës, ku goma me nr. rendor nr.10 është hedhur gabim. Konkretisht: Goma 11.00 R 20 TT 150/146 H. Ky artikull është gomë kamioni ku specifikimet teknike të vendosura për këtë artikull nga ABP-ja tregojnë që kamioni në të cilin do të përdoren këto goma, kanë një shpejtësi mbi 200 km/h. Një kamion me shpejtësi mbi 200 km/h nuk ekziston në asnjë autoritet kontraktor në Shqipëri. Në fakt një kamion i tillë nuk ekziston në asnjë vend të botës. Si rrjedhojë një gomë e tillë, pra gomë kamioni që përballon shpejtësi mbi 200 km/h nuk ekziston. Me pak fjalë ky është një lapsus i bërë nga personat që kanë bërë specifikimet teknike.

Gjithashtu bashkë me argumentat që kemi dhënë më lart po ju vëmë në dispozicion edhe përgjigje të marra nga kompanitë më të njohura në tregun shqiptar të gomave të cilat kanë një eksperiencë gati 30 vjecare në këtë treg në lidhje me mosekzistencën e gomës 11.00 R 20 TT 150/146 H. Gjithashtu bashkëlidhur po ju nisim edhe përgjigjen e marrë nga Komanda Mbështetëse e cila është dhe autoriteti që ka kërkuar këtë tip gome. Në këtë përgjigje duket qartë se goma me nr. rendor 10 në tabelë është lapsus dhe nuk ekziston dhe ska se si të ketë një katalog prodhuesi për këtë tip gome pasi indeksi H është gabim.

Ndërkohë kemi bindje të plotë se personi që ka krijuar këto dy kompani të renditura e para dhe e dyta në këtë procedurë (dhe si rrjedhojë këto dy operatorë ekonomikë) kanë paraqitur në këtë procedurë specifikime teknike dhe kataloge për artikullin nr.10 goma 11.00 R 20 TT 150/146 H njëlloj si është kërkuar në DT nga ABP-ja. Dy operatorët ekonomikë të renditur i pari dhe i dyti, kanë paraqitur katalogë ku figuron goma “11.00 R 20 TT 150/146 H” e cila nuk ekziston. Katalogët origjinale nuk mund të kenë një artikull (gomë) e cila nuk ekziston dhe jo të prodhohet. Kjo na lë të kemi bindjen e plotë dhe të faktuar tashmë me fakte konkrete se të dy operatorët ekonomikë të lartpërmendur dhe pjesë e objektit të ankesës së paraqitur nga ne të renditur i pari dhe i dyti, të kenë falsifikuar këto katalogë.

Përsa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorëve ekonomikë “R&R Group” sh.p.k dhe dhe “Ra-Mi Company” sh.p.k dhe rirenditjen edhe njëherë të operatorëve në këtë procedurë.”

II.6. Në datën 07.08.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1278/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1348/1 prot., datë 02.05.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.7. Në datën 10.09.2019 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 594/2019, ku vendosi si vijon:

- 1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., për procedurën e prokurimit me Nr.REF-21330-05-09-2019, me objekt: “Blerje goma për automjete”, Loti I, me fond limit 50.279.555 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.*
- 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.*
- 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
- 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.8. Në datën 17.09.2019 operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k është vënë në dijeni për renditjen përfundimtare të ofertave, ku në ndryshim nga hera e fundit, oferta e renditur në vendin e parë dhe konkretisht oferta e shoqërisë “R&R Group” sh.p.k me 1.237.2376 lekë shumatore e cmimeve për njësi, rezulton si ofertë e skualifikuar si vijon:

1.	“R&R Group” sh.p.k	1.237.376 lekë, skualifikuar
2.	“C.A.A” sh.p.k	1.255.000 lekë, skualifikuar
3.	“Alked Kopaci” p.f	1.484.056 lekë, skualifikuar
4.	“Ra-Mi Kompani” sh.p.k	1.979.800 lekë, kualifikuar
5.	“Klosi-R Compant” sh.p.k	2.227.277 lekë, skualifikuar
6.	“Gajd Company” sh.p.k.	2.473.000 lekë, kualifikuar

II.9. Në datën 20.09.2019 operatorie ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“Me daten 14/09/2019 u vume ne dijeni ne lidhje vendimin nr. 594/2019 te mbledhjes 10.09.2019 te KPP, ku me kete vendim KPP vendosi per mos pranimin e ankimit te shoqerise Gajd Company shpk ne lidhje me proceduren e prokurimit "Procedure e hapur" me objekt "Blerje pjesesh kembimi per automjete per sherbime profilaktike per Komanden Mbeshtetese" ndare ne 2(dy), marreveshje kuader me disa operatore ekonomik konkretisht Loti I: Blerje goma per automjete". Me date 17/09.2019 nepermjet sistemit elektronik te APP u vume ne dijeni me renditjen përfundimtare te ofertave per proceduren e lartepërmendur ku ne ndryshim me heren e fundit vume re se oferta e operatorit ekonomik te renditur me heret ne vendin e pare dhe me kenkretisht: ofertae R&R Group me 1.237.376 shumatore te cmimeve per njesi, te rezultojne ne sistem si oferte e skualifikuar.

Bazuar ne VKM Nr. 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, konkretisht nenit 58, ku ne menyre eksplicite shpjegohen kompetencat e komisionit te vleresimit te ofertave, ku nder te tjera do te nenvizomin: ... Komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave, Komisioni duhet te zbatoje detyrat ne pavaresi te plote dhe nese kerkohen sqarime per dokumentet e tenderit, keto merren nga njesia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnie veprim tjeter, pervec atyre te percaktuara shprehimisht ne keto rregulla. Pra si dhe ju mund ta lexoni, komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin e ofertave dhe si rrjedhoje kur e ka mbaruar ate faze, nuk mund ta rihape dhe te beje nje rishqyrtim por ne varesi te ceshtjeve dhe si rrjedhoja qe vijne nga pasojat ligjore te parashtruara nga ligjevenesi (ne kuadrin e hierarkise) mund te beje rikualifikimi vetem duke u bazuar: vendimin e grupit te ankesave nese ka nje te tille, vendimin e komisionit te prokurimit publik, vendime gjykate te gjitha keto lidhen me ankimimin nese eshte bere apo jo.

Sa me lart na lind e drejta t'ju pyesim se perse keni shkelur ligjin, duke bere nje rikualifikim edhe pse nuk ka pasur asnje baze apo shkak ligjor qe t'ju detyronte te benit nje dicka te tille? Pse duhet te skualifikoni operatorin ekonomik te renditur te parin duke mos pasur asnje te drejte te nderhyni edhe njehere ne shqyrtim, pasi ju e keni bere nje te tille dhe keni dale me nje vendim i cili eshte bere dhe shkak per ankimimin tone? Ky veprim thekson edhe njehere se ankimimi jone (rilexoni pjesen e pare te ankesave tone) ne pjesen e pare tij ku ne tregojme se operatoret ne fjale jane ne bashkepunim me njeri tjetrin eshte e vertete por me tej akoma veprimi juaj ju ben edhe ju bashkepunetor ne kete fiksime te tenderit ne fjale.

Ekziston edhe mundesia qe operatori ekonomik R&R Group me oferte ekonomike 1.237.376 shumatore te cmimeve per njesi te kete bere terheqje te ofertes dhe per kete besoj se duhet te jeni ne dijeni te nenit 58 te ligjit per prokurimin publik Nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar, i cili dhe ne titullin e tij eshte: Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates, pra tregon se cfare duhet te beje autoriteti kontraktor kur te shpalli fituesin kur te beje njoftimin e fituesit, ku dhe ne piken 5 te tij thuhet: "Kur ofertuesi fitues nuk ben sigurimin e kontrates ose nuk arrin te nenshkruaje kontraten, autoriteti kontraktor ben konfiskimin e sigurimit te ofertes, nese eshte kerkuar. Ne rastin kur eshte perdorur si kriter i percaktimit te ofertes fituese "cmimi me i ulet" dhe kur ofertuesi fitues nuk ben sigurimin e kontrates ose nuk arrin te nenshkruaje kontraten, autoriteti kontraktor perzgjedh ofertuesin e renditur i dyti ne listen e ofertave te perzgjedhura qe kane mbetur, vetem nese diferenca ndermjet ofertes se kualifikuar ne vendin e pare dhe te dyte do te jete jo me e madhe se 2 per qind e fondit limit. Kjo nuk cenon te drejten e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 te ketij ligji, per te refuzuar te gjitha ofertat e mbetura dhe per te anuluar proceduren e prokurimit. Njoftimi, sipas pikes 1 te ketij neni, i dergohet ofertuesit, oferta e te cilit eshte perzgjedhur sipas kesaj pike".

A mundeni ju te shpjegoni nese ligji e percakton kur eshte fitues dhe jo kur shpallet fitues? Mos ndoshta ky ofertues ishte fitues por nuk u shpall nga ju sepse ai qellimisht u terhoq dhe ju deshtuat apo me vetedije te plote nuk arritet dot te ndani kete lloj faze? Pra se kur eshte nje operator fitues dhe kur shpallet fitues. Besojme se ju keni potencialin e duhur per te bere kete dallim i cili eshte thelbesor ne jurisprudence, por kjo qe ju keni bere eshte nje shkelje flagrante e ligjit. Ky veprim i operatorit ne fjale nese e ka bere nje te tille tregon dhe verteton edhe ankimimin tone ne lidhje me keta operatore. Dhe nese ky operator nuk ploteson dot kushtet per ta realizuar kete kontrate jemi

po ne ankimimin tone te drejte se operatori i renditur i pare nuk plotesonte kushtet dhe realizimi ishte i pamundur pasi edhe oferta ishte anomalisht e ulet por qe organi juaj ktheu pergjigje duke treguar se sa me besueshmeri e kishte argumentuar oferten ky operator. Mos ndoshta dikush ketu nuk e ka bere punen e vet? Pune per te cilen paguhet me taksat tona dhe pikerisht ate pune per te verifikuar dhe per te shqyrtuar? Bazuar ne faktet e pakundershtueshme te shkeljes se ligjit per prokurimin publik Nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM Nr. 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, kerkojme anulimin e procedures se lartepemendur dhe rihedhjen edhe njehere te saj, duke bere regullim edhe te gabimeve qe jane konstatuar ne numrin e gomave qe ju kemi permendur me heret ne ankese.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 1632/2 prot., datë 26.09.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si më poshtë vijon:

"[...] Pasi u verifikuan pretendimet e parashtuara në ankesën e ofertuesit "Gajd Company" shpk, me nr. 632 prot., datë 20.09.2019, sqarojmë si më poshtë:

Së pari; Ankimuesi "Gajd Company" shpk ka paraqitur me herët ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me datë 19.07.2019, në lidhje me vlerësimin e ofertave, të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në organin qendror blerës ABP. Në lidhje me këtë ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të vendimit nr. 594/2019 , datë 10.09.2019 ka vendosur të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Gajd Company" shpk për procedurën e prokurimit objekt ankimimi. Pra Komisioni i Prokurimit Publik ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në ABP mbi mospranimin e ankesës, duke mos ndryshuar vlerësimin e bërë me datë 27.06.2019 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në organin qendror blerës. Për rrjedhim, shqyrtimi i ankesës suaj mbi pretendimet ndaj 2 ofertuesve të tjerë të kualifikuar e të renditur në vend të parë dh etë dytë, përpara ofertuesit "Gajd Company" sh.p.k i renditur i treti, është ezauruar administrativisht. Përfundimidht ju sqarojmë se kundër vendimit nr. 594/2019 datë 10.09.2019 të KPP-së ju mund të paraqitni ankim në gjykatë, në mbështetje të pikës I të nenit 64/3 të ligjit nr. 9643, datë 2011.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Së dyti; Procedura e prokurimiti ka qënë e pezulluar nga organi qendror blerës , i cili nuk ka kryer asnjë veprim në SPE deri në marrjen ë vendimit përfundimtar nga KPP, i ardhur zyrtarisht në ABP me datë 12/09.2019 (publikuar në faqen zyrtare në internet të KPP-së me datë 10.09.2019). Referuar klasifikimit përfundimtar të ofertuesve të kualifikuar, të lënë në fuqi me vendimin nr. 594/2019 , datë 10.09.2019 të KPP-së rezulton si vijon:

- | | | | |
|----|------------------------|-----------------|------------------|
| 1. | "R&R Group" sh.p.k | 1.237.376 lekë, | renditur i pari |
| 2. | "Ra-Mi Kompani" sh.p.k | 1.979.800 lekë, | renditur i dyti |
| 3. | "Gajd Company" sh.p.k. | 2.473.000 lekë, | renditur i treti |

Përsa më sipër, ofertuesi "R&R Group" shpk i renditur i pari, ka depozituar në organi qendror blerës ABP, kërkesën me nr.8 prot., datë 11.09.2019 (protokolluar me tonën nr. 1562 prot., datë 13.09.2019) , me anë të së cilës ka kërkuar të tërhiqet nga oferta e paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Me anë të kësaj kërkesë ofertuesi "R&R Group" sh.p.k ka shprehur vullnetin për tu tërhequr nga realizimi i kontratës duke dhënë edhe argumentat përkatëse.

Sqarojmë se kërkesa për tërheqje nga oferta është paraqitur përpara se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në ABP të njëjët me vendimin e KPP-së e për rrjedhim nuk rezulton të jetë përgatitur dhe paraqitur për miratim pranë titullarit raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit, që hartohet dhe miratohet në përputhje me nenin 21, 68 dhe 69 të VKM-së 914/2014.

Organi qëndror blerës ka marrë parasysh kërkesën për tërheqje nga oferta të ofertuesit “R&R Group” sh.p.k , duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit që lidhen me evidentimin e skualifikimit të këtij ofertuesi së sistemin e prokurimit elektronik nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i cili ka bërë rivlerësimin e ofertave me datë 17.09.2019 në SPE, duke skualifikuar ofertuesin “R&R Group” sh.p.k për arsye të tërheqjes nga oferta, pa rënë ndesh me vendimin e KPP-së.

Së treti; Ju sjellim në vëmendje se në këtë procedurë prokurimi nuk është kërkuar sigurim oferte në dokumentat e tenderit. Gjithashtu nga organi qëndror blerës nuk është njoftuar dhe as nuk është shpallur ofertues fitues prandaj të gjitha pretendimet tuaja në lidhje me moszbatimin e nenit 58 të LPP-së nuk qëndrojnë, pasi organi qëndror blerës nuk ndidhet në fazën e zbatimit të këtij neni, por ndodhet në fazën e klasifikimit të ofertave sipas nenit 67 të VKM-së 914/2014, i ndryshuar.

Përsa më sipër ju sqarojmë se faza e njoftimit të fituesit zhvillohet pas fazës së hartimit dhe miratimit të raportit përmbledhës, në zbatim të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin erregullavetë prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 21 “Njoftimi i fituesit”, pika 1 ku thuhet [...].

Së katërti; Në lidhje me pretendimin tuaj për anulimin e procedurës së prokurimit, ju sjellim në vëmendje se organi qëndror blerës nuk ndodhet përpara ndonjë prej rasteve të anulimit, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 24 të LPP-së

Për arsyet e mësipërme, pretendimet e ankimuesit “Gajd Company” shpk nuk pranohen.”

II.11. Në datën 04.10.2019 operatori ekonomik ankimues “Gajd Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.12. Në datën 18.10.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1576/2 prot., shkresa e autoritetit nr. 1576/1 prot., datë 17.10.2019 me objekt: “Dërgohet dokumentacion për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje goma për automjete”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “[...]Me date 17/09.2019 nepermjet sistemit elektronik te APP u vume ne dijeni me renditjen perfundimtare te ofertave per proceduren e lartepemendur ku ne ndryshim me heren e fundit vume re se oferta e operatorit ekonomik te renditur

me heret ne vendin e pare dhe me kenkretisht: oferta e R&R Group me 1.237.376 shumatore te cmimeve per njesi, te rezultoje ne sistem si oferte e skualifikuar. Bazuar ne VKM Nr. 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, konkretisht nenit 58, ku ne menyre eksplicite shpjegohen kompetencat e komisionit te vleresimit te ofertave, ku nder te tjera do te nenvizomin: ... Komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave, Komisioni duhet te zbatoje detyrat ne pavaresi te plote dhe nese kerkohen sqarime per dokumentet e tenderit, keto merren nga njesia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnie veprim tjetër, pervec atyre te percaktuara shprehimisht ne keto rregulla. Pra si dhe ju mund ta lexoni, komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin e ofertave dhe si rrjedhoje kur e ka mbaruar ate faze, nuk mund ta rihape dhe te beje nje rishqyrtim por ne varesi te ceshtjeve dhe si rrjedhoja qe vijne nga pasojat ligjore te parashtruara nga ligjevenes (ne kuadrin e hierarkise) mund te beje rikualifikimi vetem duke u bazuar: vendimin e grupit te ankesave nese ka nje te tille, vendimin e komisionit te prokurimit publik, vendime gjykate te gjitha keto lidhen me ankimimin nese eshte bere apo jo. Sa me lart na lind e drejta t'ju pyesim se perse keni shkelur ligjin, duke bere nje rikualifikim edhe pse nuk ka pasur asnje baze apo shkak ligjor qe t'ju detyronte te benit nje dicka te tille? Pse duhet te skualifikoni operatorin ekonomik te renditur te parin duke mos pasur asnje te drejte te nderhyni edhe njehere ne shqyrtim, pasi ju e keni bere nje te tille dhe keni dale me nje vendim i cili eshte bere dhe shkak per ankimimin tone? Ky veprim thekson edhe njehere se ankimimi jone (rilexoni pjesen e pare te ankesave tone) ne pjesen e pare tij ku ne tregojme se operatoret ne fjale jane ne bashkepunim me njeri tjetrin eshte e vertete por me tej akoma veprimi juaj ju ben edhe ju bashkepunetor ne kete fiksime te tenderit ne fjale. Ekziston edhe mundesia qe operatori ekonomik R&R Group me oferte ekonomike 1.237.376 shumatore te cmimeve per njesi te kete bere terheqje te ofertes dhe per kete besoj se duhet te jeni ne dijeni te nenit 58 te ligjit per prokurimin publik Nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar, i cili dhe ne titullin e tij eshte: Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates, pra tregon se cfare duhet te beje autoriteti kontraktor kur te shpalli fituesin kur te beje njoftimin e fituesit, ku dhe ne piken 5 te tij thuhet: "Kur ofertuesi fitues nuk ben sigurimin e kontrates ose nuk arrin te nenshkruaje kontraten, autoriteti kontraktor ben konfiskimin e sigurimit te ofertes, nese eshte kerkuar. Ne rastin kur eshte perdorur si kriter i percaktimit te ofertes fituese "cmimi me i ulet" dhe kur ofertuesi fitues nuk ben sigurimin e kontrates ose nuk arrin te nenshkruaje kontraten, autoriteti kontraktor perzgjedh ofertuesin e renditur i dyti ne listen e ofertave te perzgjedhura qe kane mbetur, vetem nese diferenca ndermjet ofertes se kualifikuar ne vendin e pare dhe te dyte do te jete jo me e madhe se 2 per qind e fondit limit. Kjo nuk cenon te drejten e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 te ketij ligji, per te refuzuar te gjitha ofertat e mbetura dhe per te anuluar proceduren e prokurimit. Njoftimi, sipas pikes 1 te ketij neni, i dergohet ofertuesit, oferta e te cilit eshte perzgjedhur sipas kesaj pike". A mundeni ju te shpjegoni nese ligji e percakton kur eshte fitues dhe jo kur shpallet fitues? Mos ndoshta ky ofertues ishte fitues por nuk u shpall nga ju sepse ai qellimisht u terhoq dhe ju deshtuat apo me vetedije te plote nuk arritet dot te ndani kete lloj faze? Pra se kur eshte nje operator fitues dhe kur shpallet fitues. Besojme se ju keni potencialin e duhur per te bere kete dallim i cili eshte thelbesor ne jurisprudence, por kjo qe ju keni bere eshte nje shkelje flagrante e ligjit. Ky veprim i operatorit ne fjale nese e ka bere nje te tille tregon dhe verteton edhe ankimimin tone ne lidhje me keta operatore. Dhe nese ky operator nuk ploteson dot kushtet per ta realizuar kete kontrate jemi po ne ankimimin tone te drejte se operatori i renditur i

pare nuk plotesonte kushtet dhe realizimi ishte i pamundur pasi edhe oferta ishte anomalisht e ulët por që organi juaj ktheu përgjigje duke treguar se sa me besueshmeri e kishte argumentuar oferten ky operator. Mos ndoshta dikush ketu nuk e ka bere punen e vet? Pune per te cilen paguhet me taksat tona dhe pikerisht ate pune per te verifikuar dhe per te shqyrtuar? Bazuar ne faktet e pakundershtueshme te shkeljes se ligjit per prokurimin publik Nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM Nr. 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, kerkojme anulimin e procedures se lartepemendur dhe rihedhjen edhe njehere te saj, duke bere regullim edhe te gabimeve qe jane konstatuar ne numrin e gomave qe ju kemi permendur me heret ne ankese [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të depozituar në KPP nga autoriteti kontraktor rezulton se: “Referuar klasifikimit përfundimtar të ofertuesve të kualifikuar, të lënë në fuqi me vendimin nr. 594/2019, datë 10.09.2019 të KPP-së rezulton si vijon:

- | | | | |
|----|------------------------|-----------------|------------------|
| 1. | “R&R Group” sh.p.k | 1.237.376 lekë, | renditur i pari |
| 2. | “Ra-Mi Kompani” sh.p.k | 1.979.800 lekë, | renditur i dyti |
| 3. | “Gajd Company” sh.p.k. | 2.473.000 lekë, | renditur i treti |

Ofertuesi “R&R Group” shpk i renditur i pari, ka depozituar në organi qendror blerës ABP, kërkesën me nr.8 prot., datë 11.09.2019 (protokolluar në AK nr. 1562 prot., datë 13.09.2019), me anë të së cilës ka kërkuar të tërhiqet nga oferta e paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Me anë të kësaj kërkesë ofertuesi “R&R Group” sh.p.k ka shprehur vullnetin për tu tërhequr nga realizimi i kontratës duke dhënë edhe argumentat përkatëse.

III.1.2. Në datën 17.09.2019 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve dhe ofertuesit janë vënë në dijeni me renditjen përfundimtare të ofertave si më poshtë vijon:

- | | | |
|----|--------------------------|------------------------------|
| 1. | “R&R Group” sh.p.k | 1.237.376 lekë, skualifikuar |
| 2. | “C.A.A” sh.p.k | 1.255.000 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Alked Kopaci” p.f | 1.484.056 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Ra-Mi Kompani” sh.p.k | 1.979.800 lekë, kualifikuar |
| 5. | “Klosi-R Compant” sh.p.k | 2.227.277 lekë, skualifikuar |
| 6. | “Gajd Company” sh.p.k. | 2.473.000 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomi “R&R Group” shpk rezulton i skualifikuar me argumentin:

“Terhequr nga oferta me shkresen protokolluar me tonën me nr. 1562 prot., date 13.09.2019”

III.1.3. Në nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Oferta fituese duhet të jetë:

- a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose*
- b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca*

teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

4. Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.

5. Autoriteti kontraktor përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

III.1.4. Në nenin 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 5, përcaktohet se:

“Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “çmimi më i ulët” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se 2 për qind e fondit limit. Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e prokurimit. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.”

III.1.5. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “R&R Group” sh.p.k, sipas klasifikimit të ofertave të datës 27.06.2019, rezulton i pari në renditjen përfunditare të ofertave me vlerë 1.237.376 lekë pa tvsh dhe i dytë është renditur shoqëria “Ra-Mi Kompani” sh.p.k me vlerë 1.979.800 lekë pa tvsh. Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Gajd Security” sh.p.k, i cili kundërshtonte kualifikimin e dy shoqërive të kualifikuara përkatësisht në vend të parë dhe të dytë, Komisioni i Prokurimit Publik nëpërmjet vendimit KPP 594/2019, datë 10.09.2019 la në fuqi vendimin e autoritetit kontraktor, duke e lejuar atë të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit objekt ankimimi. Në datën 13.10.2019 autoriteti kontraktor është vënë në dijeni nga operatori ekonomik “R&R Group” sh.p.k për tërheqjen e ofertës së tij, e cila rezultonte oferta fituese, në kuptim të nenit 55 të LPP-së si më sipër cituar.

III.1.6. Në dokumentat e tenderit të mësipërm është parashikuar: *“Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është: Për Lotin I: shumatorja e çmimeve për njësi është 2,474,751.25(dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një pikë njëzet e pesë).*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar klasifikimit përfundimtar të ofertuesve të kualifikuar, të lënë në fuqi me vendimin nr. 594/2019 , datë 10.09.2019 të KPP-së rezulton:

1. “R&R Group” sh.p.k 1.237.376 lekë, renditur i pari
2. “Ra-Mi Kompani” sh.p.k 1.979.800 lekë, renditur i dyti

Diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është 742.424 lekë, ndërkohë që 2% e fondit limit rezulton 49.495 lekë. Pra diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë në vlerën 742.424 lekë është disa herë më e madhe se 2 për qind e fondit limit (49.495 lekë), duke sjellë si pasojë pamundësinë e kalimit në ofertën e renditur në vendin e dytë, pas tërheqjes së ofertës nga ana e shoqërisë “R&R Group” sh.p.k, referuar bazes ligjore të sipërcituar. Në këto kushte autoriteti kontraktor duhet të refuzojë të gjitha ofertat e mbetura dhe të anulojë procedurën e prokurimit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., për procedurën e prokurimit me Nr.REF-21330-05-09-2019, me objekt: “Blerje goma për automjete”, Loti I, me fond limit 50.279.555 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1576 Protokolli

Datë 04.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Vilma Zhupaj (Anëtar) dhe znj. Lindita Skeja (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtarë të KPP shprehim mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij përsa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k. Konkretisht nuk jemi dakord me arsyetimin në pikën III.1, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me objekt: “Anulimin e procedurës së prokurimit me Nr.REF-21330-05-09-2019, me objekt: “Blerje goma për automjete”, Loti I, me fond limit 50.279.555 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara”.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë:

I. Lidhur me pretendimet e ankimesit se: “[...]Me date 17/09.2019 nepermjet sistemit elektronik te APP u vume ne dijeni me renditjen perfundimtare te ofertave per proceduren e lartepemendur ku ne ndryshim me heren e fundit vume re se oferta e operatorit ekonomik te renditur me heret ne vendin e pare dhe me kenkretisht: oferta e R&R Group me 1.237.376 shumatore te cmimeve per njesi, te rezultoje ne sistem si oferte e skualifikuar. Bazuar ne VKM Nr. 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, konkretisht nenit 58, ku ne menyre eksplicite shpjegohen kompetencat e komisionit te vleresimit te ofertave, ku nder te tjera do te nenvizomin: ... Komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave, Komisioni duhet te zbatoje detyrat ne pavaresi te plote dhe nese kerkohen sqarime per dokumentet e tenderit, keto merren nga njesia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnie veprim tjeter, pervec atyre te percaktuara shprehimisht ne keto rregulla. Pra si dhe ju mund ta lexoni, komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin e ofertave dhe si rrjedhoje kur e ka mbaruar ate faze, nuk mund ta rihape dhe te beje nje rishqyrtim por ne varesi te ceshtjeve dhe si rjedhoja qe vijne nga pasojat ligjore te parashtruara nga ligjevenesi (ne kuadrin e hierarkise) mund te beje rikualifikimi vetem duke u bazuar: vendimin e grupit te ankesave nese ka nje te tille, vendimin e komisionit te prokurimit publik, vendime gjykate te gjitha keto lidhen me ankimimin nese eshte bere apo jo. Sa me lart na lind e drejta t'ju pyesim se perse keni shkelur ligjin, duke bere nje rikualifikim edhe pse nuk ka pasur asnje baze apo shkak ligjor qe t'ju detyronte te benit nje dicka te tille? Pse duhet te skualifikoni operatorin ekonomik te renditur te parin duke mos pasur asnje te drejte te nderhyni edhe njehere ne shqyrtim, pasi ju e keni bere nje te tille dhe keni dale me nje vendim i cili eshte bere dhe shkak per ankimimin tone? Ky veprim thekson edhe njehere se ankimimi jone (rilexoni pjesen e pare te ankesave tone) ne pjesen e pare tij ku ne tregojme se operatoret ne fjale jane ne bashkepunim me njeri tjetrin eshte e vertete por me tej akoma veprimi juaj ju ben edhe ju bashkepunetor ne kete fiksim te tenderit ne fjale. Ekziston edhe mundesia qe operatorin ekonomik R&R Group me oferte ekonomike 1.237.376 shumatore te cmimeve per njesi te kete bere terheqje te ofertes dhe per kete besoj se duhet te jeni ne dijeni te nenit 58 te ligjit per prokurimin publik Nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar, i cili dhe ne titullin e tij eshte: Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates, pra

tregon se çfare duhet te beje autoriteti kontraktor kur te shpalli fituesin kur te beje njoftimin e fituesit, ku dhe ne piken 5 te tij thuhet: "Kur ofertuesi fitues nuk ben sigurimin e kontrates ose nuk arrin te nenshkruaje kontraten, autoriteti kontraktor ben konfiskimin e sigurimit te ofertes, nese eshte kerkuar. Ne rastin kur eshte perdorur si kriter i percaktimit te ofertes fituese "cmimi me i ulet" dhe kur ofertuesi fitues nuk ben sigurimin e kontrates ose nuk arrin te nenshkruaje kontraten, autoriteti kontraktor perzgjedh ofertuesin e renditur i dyti ne listen e ofertave te perzgjedhura qe kane mbetur, vetem nese diferenca ndermjet ofertes se kualifikuar ne vendin e pare dhe te dyte do te jete jo me e madhe se 2 per qind e fondit limit. Kjo nuk cenon te drejten e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 te ketij ligji, per te refuzuar te gjitha ofertat e mbetura dhe per te anuluar proceduren e prokurimit. Njoftimi, sipas pikes 1 te ketij neni, i dergohet ofertuesit, oferta e te cilit eshte perzgjedhur sipas kesaj pike". A mundeni ju te shpjegoni nese ligji e percakton kur eshte fitues dhe jo kur shpallet fitues? Mos ndoshta ky ofertues ishte fitues por nuk u shpall nga ju sepse ai qellimisht u terhoq dhe ju deshtuat apo me vetedije te plote nuk arritet dot te ndani kete lloj faze? Pra se kur eshte nje operator fitues dhe kur shpallet fitues. Besojme se ju keni potencialin e duhur per te bere kete dallim i cili eshte thelbesor ne jurisprudence, por kjo qe ju keni bere eshte nje shkelje flagrante e ligjit. Ky veprim i operatorit ne fjale nese e ka bere nje te tille tregon dhe verteton edhe ankimimin tone ne lidhje me keta operatore. Dhe nese ky operator nuk ploteson dot kushtet per ta realizuar kete kontrate jemi po ne ankimimin tone te drejte se operatori i renditur i pare nuk plotesonte kushtet dhe realizimi ishte i pamundur pasi edhe oferta ishte anomalisht e ulet por qe organi juaj ktheu pergjigje duke treguar se sa me besueshmeri e kishte argumentuar oferten ky operator. Mos ndoshta dikush ketu nuk e ka bere punen e vet? Pune per te cilen paguhet me taksat tona dhe pikerisht ate pune per te verifikuar dhe per te shqyrtuar? Bazuar ne faktet e pakundershtueshme te shkeljes se ligjit per prokurimin publik Nr. 9643, date 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM Nr. 914, date 29.12.2014 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, kerkojme anulimin e procedures se lartepemendur dhe rihedhjen edhe njehere te saj, duke bere rregullim edhe te gabimeve qe jane konstatuar ne numrin e gomave qe ju kemi permendur me heret ne ankese [...]", vërejmë se:

I.1. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor rezulton se: "Referuar klasifikimit përfundimtar të ofertuesve të kualifikuar, të lënë në fuqi me vendimin nr. 594/2019, datë 10.09.2019 të KPP-së rezulton si vijon:

4.	"R&R Group" sh.p.k	1.237.376 lekë,	renditur i pari
5.	"Ra-Mi Kompani" sh.p.k	1.979.800 lekë,	renditur i dyti
6.	"Gajd Company" sh.p.k.	2.473.000 lekë,	renditur i treti

Ofertuesi "R&R Group" shpk i renditur i pari, ka depozituar në organi qendror blerës ABP, kërkesën me nr.8 prot., datë 11.09.2019 (protokolluar në AK nr. 1562 prot., datë 13.09.2019), me anë të së cilës ka kërkuar të tërhiqet nga oferta e paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Me anë të kësaj kërkesë ofertuesi "R&R Group" sh.p.k ka shprehur vullnetin për tu tërhequr nga realizimi i kontratës duke dhënë edhe argumentat përkatëse.

I.2. Në datën 17.09.2019 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të ofertave dhe ofertuesit janë vënë në dijeni me renditjen përfundimtare të ofertave si më poshtë vijon:

7.	“R&R Group” sh.p.k	1.237.376 lekë, skualifikuar
8.	“C.A.A” sh.p.k	1.255.000 lekë, skualifikuar
9.	“Alked Kopaci” p.f	1.484.056 lekë, skualifikuar
10.	“Ra-Mi Kompani” sh.p.k	1.979.800 lekë, kualifikuar
11.	“Klosi-R Compant” sh.p.k	2.227.277 lekë, skualifikuar
12.	“Gajd Company” sh.p.k.	2.473.000 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomi “R&R Group” shpk rezulton i skualifikuar me argumentin:

“Terhequr nga oferta me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1562 prot., date 13.09.2019”

I.3. Në nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Oferta fituese duhet të jetë:

- a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose*
- b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese*

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

4. Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.

5. Autoriteti kontraktor përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

I.4. Në nenin 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, përcaktohet se:

“1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

2. Brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të fituesit, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik për botimin në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, njoftimi i fituesit dërgohet në platformën elektronike të prokurimit, ditën e nesërme të punës nga marrja e vendimit.

Njoftimi përmban minimalisht këtë informacion:

- a) emrat e ofertuesve pjesëmarrës;*
- b) vlerat e ofertave;*

c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ç) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij; d) ankesa, nëse ka pasur ose jo të tilla.

3. Autoriteti kontraktor dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën, sipas afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në çdo rast kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

4. Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti kontraktor.

5. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “çmimi më i ulët” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se 2 për qind e fondit limit. Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e prokurimit. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.

6. Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ, sipas kreut VII të këtij ligji, e bën atë absolutisht të pavlefshme.”

I.5. Referuar informacionit të siguruar nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) si dhe informacionit të sjellë nga autoriteti kontraktor rezulton që autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara nuk ka shpallur ofertues fitues por procedura ndodhet në fazën e klasifikimit të ofertave sipas nenit 67 VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përsa rrjedhojë, duke qënë se procedura e prokurimit ndodhet në fazën e vlerësimit të ofertave dhe jo në atë të njoftimit të fituesit, gjykojmë se në rastin konkret, nuk ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 58 si më sipër cituar.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Anëtar

Vilma Zhupaj

Anëtar

Lindita Skeja